



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1076/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Besarta Sadiku, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 16.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt apeli i parashtruar nga Besarta Sadiku, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me shenjen ZL.Anr.1076/2017, të datës 16.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i me datë 16.11.2017 ka pranuar apelin ZL.Anr.1076/2017 të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 10.11.2017, nga Besarta Sadiku, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal në Gjakovë, nga subjekti politik PDK, dega në Gjakovë të dërguar nëpërmjet postës më datë 10.11.2017, me të cilën ka pretenduar se në disa qendra të votimit në Komunën e Gjakovës i mungojnë votat.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga Besarta Sadiku, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat e Rregullës Nr.02/2015

të nenit 5.6 ku përcaktohet se: “Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”.

Prandaj, PZAP-i nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshteje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja
ZL Anr.1076/2017 më datën 16.11.2017



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.